

V E N D I M
Nr.467, datë 4.9.1995

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.190, DATË 3.5.1995
“PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7874,DATË 17.11.1994 “PËR STATUSIN E VETERANIT TË
LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË”

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 190, datë 3.5.1995, pas pikës 14 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje: “Në funksion të Komisionit qendror të departamentit të veteranëve dhe invalidëve të luftës e të ushtrisë dhe të komisioneve të rretheve, Ministria e Mbrojtjes mund të angazhojë në punë specialistë veteranë të luftës e të ushtrisë. Shpërblimi i tyre të jetë i njëjlojtë me atë të anëtarëve të komisioneve të rretheve që nuk janë në marrëdhënie pune, në përputhje me pikën 14 të këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi